



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 02-020-01-8047-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg. 24. 03. 2025

Data / Datum / Date

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komuna Obiliq

Opština Obilič - Municipality Obiliq



ZYRA E KRYETARIT

Kabinet Presednika – Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13 dhe 68 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 të dt. 04.06.2008), Statutit të Komunës nr. I-34 të dt. 25.04.2016, Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna te dt.14.12.2023., Kryetari i Komunës me dt. 24.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Emërohet Grupi punues për hartimin e projekt propozimit, i caktuar nga organi kompetent I Komunës, me këtë përbërje:

1. Adem Haliti – zyrtare për Informim – koordinatorë,
2. Lavdim Uka – zyrtar i IT-së,
3. Mimoza Hashani – DAP
4. Majlinda Kutllavci – Zyre e personeli
5. Faton Grajçevci– DKRS
6. Sylejman Gllareva – Zyra e personelit
7. Flaka Hashani – DEFZH
8. Hamit Mjeku – DSHPE
9. Vlora Halimi – DPUPK
10. Muhamed Ismajli – DBZHR
11. Fazli Pervetica – DMM
12. Osman Kabashi – DIL
13. Urim Grajçevci – DA

II. Grupi punues është përgjegjës për hartimin e projek-propozimit, i cili i nënshtrohet procesit të konsultimit publik para aprovimit të tij.

III. Grupi punues do të punoj sipas Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna te dt.14.12.2023.

IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

Vendimi t'i dorëzohet

- Zyrës së Kryetarit
- Anëtarëve të grupit punues
- Gjithë drejtorëve
- Arkivit



Kryetari i Komunës

Xhafer Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No.

02-400-04-7854-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date

21.03.2025

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

ZYRA E KRYETARIT/KABINET PREDSEDNIKA// OFFICE OF THE MAYOR

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt. 04.06.2008), neni 73 të Statutit të Komunës nr.I-34 i dt. 25.04.2016, Vendimit të Kryetarit nr.02-020-01-348-25 i dt.06.01.2025 për lejimin e ndarjes së mjeteve për nënat lehona, Vendimit të Komisionit nr. 02-020-01-352-25 i dt. 06.01.2025, Raportit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave nr.08-052-01-7750-25 i dt. 20.03.2025, Kryetari i Komunës, me datë 21.03.2025, merr këtë

V E N D I M

I. Miratohet vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për përfituesit nga Lista e përfituesëve sipas raportit të Komisionit, "Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për nënat lehona të komunës së Obiliqit", në drejtorinë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

II. Mjetet ndahen nga subvencionet e DSHMS-së për përfituesit sipas raportit të Komisionit nr. 08-052-01-7750-25 i dt. 20.03.2025.

III. Obligohet DEFZH-ja dhe DSHMS-ja të zbatojnë këtë vendim.

IV. Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit.

T'i dorëzohet ;

- Kryetarit të Komunës
- Drejtorit të DSHMS,
- Drejtorit të DEFZh;
- Drejtorit DAP
- Arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Komuna Obiliq / Opština Obilič / Municipality Obiliq
13.03.2025
Opština Obilič - Municipality Obiliq - OBILIČ - OBILIC



ZYRA E KRYETARIT

Kabinet Presednika – Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare nr.28 te dt.04.06.2008), nenit 73 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, më 13.03.2025 mori këtë:

V E N D I M

- I. Emërohet Grupi Punues për përcjelljen e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024-2025 ne Komunën e Obiliqit, në përbërje:
 1. Fitore Hashani – kordinatore e grupit
 2. Zarife Behluli – DEFZH
 3. Afërdita Hashani – DEFZH sektori i tatimit ne prone
 4. Hamide Shabani – DEFZH sektori I zhvillimit ekonomik
 5. Hamdi Grajçevci, Besnik Salihu, Flaka Hashani dhe Shqipe Sylejmani – DEFZH sektori per buxhet dhe financa
 6. Leonarda Emini – zyra e prokurimit
 7. Blerona Shabanaj Mehmeti dhe Luljeta Grajçevci – DSHMS
 8. Hamit Mjeku – DSHPE
 9. Merita Simnica – DPUKP
 10. Osman Kabashi – DIL
 11. Rexhep Zeka dhe Agim Preniqi – DKA
 12. Bejtullah Mjekiqi – DBZHR
 13. Antigona Morina – NjBNj
 14. Suzana Hashani, Lavdim Uka dhe Florije Mehani – DAP
 15. Faton Grajçevci dhe Rifadije Paloji – DKRS
 16. Hajrullah Preniqi – DI
 17. Drita Hashani – zyra ligjore
- II. Grupi punues për punën e tij do të mbaj procesverbal dhe do t'i raportoj Kryetarit të Komunës.
- III. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

T'i dorëzohet:

- Kryetarit të Komunës
- anëtarëve të komisionit
- Drejtorit të DAP
- Drejtorit të DBZHR
- APK
- arkivit





Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Komuna Obiliq
Opština Obilić - Municipality Obiliq



ZYRA E KRYETARIT
Kabinet Presednika – Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, Statutit të Komunës (nr.I-34 te dt.25.04.2016), Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare nr.20/21.06.2016), Udhëzim Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, duke u mbështetur ne Memorandumin e bashkëpunimit me DEMOS-in, Kryetari i Komunës së Obiliqit, më 27.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Miratohet vendimi për themelimin e Grupit Punues përgjegjës për dëgjime buxhetore ne Komunën e Obiliqit, në këtë përbërje :

1. Besnik Salihu/ZKF– Koordinator i grupit
2. Zarife Behluli- Drejtoresh e DEFZH
3. Adem Haliti - Zyrtar për Informim publik
4. Festina Preniqi- Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun
5. Visar Aliu- zyrtar ne DBZHR
6. Besart Berisha- zyrtar ne DEFZH
7. Faton Grajqevci- zyrtar ne DKRS
8. Agim Preniqi- zyrtar ne Drejtoria e Arsimit
9. Leonora Morina - zyrtar ne DSHMS
10. Djellza Hashani – zyrtare për informim

II. Përgjegjësit e grupit punues gjatë fazës përgatitore, bëjnë pjesë përgjegjësitë si në vijim:

- Identifikimi i grupeve të qytetarëve përmes përdorimit të bazës së të dhënave komunale të grupeve të interesit
- Përgatitja e planit të dëgjimeve buxhetore për Kornizë Afatmesme Buxhetore dhe buxhet vjetor komunal, duke përfshirë në mes tjerash, përcaktimin e numrit të dëgjimeve buxhetore, vendit, kohës, etj.
- Përgatitja e materialeve që janë të nevojshme gjatë dëgjimeve buxhetore, si: ftesat e personalizuara (nëse konsiderohet e nevojshme) apo ato që publikohen në uebfaqe e rrjete sociale (apo forma të tjera) të Komunës, modelit të procesverbalit të takimit, listës së pjesëmarrësve, etj.
- Përgatitja e informacioneve të buxhetit që do tu prezantohen qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore (përfshirë buxhetin në dispozicion për projekte të reja), në një format të vizualizuar dhe lehtë të kuptueshëm për qytetarët

III. Përgjegjësit e grupit punues gjatë dëgjimeve buxhetore, bëjnë pjesë përgjegjësitë si në vijim:

- Prezantimi i informacioneve të buxhetit (me theks të veçantë në paraqitjen transparente të buxheteve të disponueshme për konsultim me qytetarët për projekte të reja nga kategoria e investimeve kapitale)
- Ndarja e listave të pjesëmarrësve për nënshkrim
- Mbajtja e procesverbaleve të takimit
- Moderimi dhe fasilitimi/lehtësimi i dëgjimit buxhetor (me theks të veçantë në nxitjen e diskutimit dhe pranimin e ideve dhe kërkesave nga qytetarët, e po ashtu në nxitjen e validimit të kërkesave të qytetarëve nga komuniteti i pranishëm në dëgjim buxhetor, sidomos atyre që në bazë të argumentimit konsiderohen se janë prioritare dhe urgjente për tu realizuar)

IV. Përgjegjësit e ndryshëm të grupit punues gjatë fazës pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, bëjnë pjesë përgjegjësitë si në vijim:


- Përpilimi i kriterëve/arsyeve për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve dhe kategorizimit e prioritizimit për pranimin dhe refuzimin e tyre
- Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të pranura gjatë dëgjimeve buxhetore dhe të tjera që pranohen me shkrim (rrjete sociale, email, uebfaqe) apo forma të tjera si takime të rregullta me Kryetarët apo të ngjashme.
- Hartimi i një raporti të detajuar të konsultimeve publike ku evidentohen dhe elaborohen të gjitha kërkesat e pranura të qytetarëve dhe jo vetëm ato të pranura fizikisht gjatë dëgjimeve buxhetore.
- Publikimi i raportit të konsultimeve publike në faqen e internetit të komunës dhe sipas kërkesave dhe afateve kohore të Udhëzimit Administrativ për Administratë të hapur

V. Grupi punues për dëgjime buxhetore duhet të specifikoj edhe vlerësimin e kërkesave të pranura nga qytetarët dhe se cila pranohet apo refuzohet, po ashtu një lloj kategorizimi rreth atyre që konsiderohet se janë më prioritare nisur nga mundësitë buxhetore, prioritetet komunale, projektet në vazhdimësi e po ashtu premtimet.

VI. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

T'i dorëzohet

- Kryetarit të Komunës
- gjithë drejtoreve.
- Anëtarëve të grupit punues
- Arkivit

Kryetari i Komunës

Xhafer Gashi





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIQ

Nr. Br. No.

02-020-01-7855-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date

21.03.2025

OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova



Komuna Obiliq
Opština Obilič - Municipality Obiliq

ZYRA E KRYETARIT
Kabinet Predsednika – Office of the Mayor

Ne mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 81 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenit 72 dhe 73 të Statutit të Komunës nr. I-34 të dt. 25.04.2016 dhe kërkesës nr. 13-370-01-7782-25 të dt. 20.03.2025 nga Zyra e Prokurimit, kryetari i komunës me dt. 21.03.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Emërohet menaxher i kontratës **Fahrije Kelmendi** për projektin “Asgjësimi i barnave me afat të skaduar dhe mbetjeve mjekësore” me nr. të prokurimit OB614-24-1024-2-3-6.
- II. Punët kryhen nga Operatori Ekonomik: “PRINCI COMPANY” SH.P.K.
- III. Menaxheri i projektit ka për detyrë që të plotësojë planet për menaxhimin e kontratës ku specifikohen te gjitha përgjegjësit e tij.
- IV. Menaxheri i projektit për punën e tij duhet ti raportojë DSHMS, DEFZH dhe Zyrën e prokurimit.
- V. Punimet duhet te kryhet brena 12 muaj nga dita e hyrjes ne fuqi te kontratës.

Te dorëzohet:

- Kryetarit,
- Drejt. DSHMS
- Menaxh. Projekt.
- Prokurimit,
- arkivit



Kryetari i Komunës

Xhafer Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 02-020-01-7648-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date

19.03.2025

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova

Komuna Obiliq
Opština Obilić - Municipality Obili



ZYRA E KRYETARIT
Kabinet Presednika – Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare nr.28 te dt.04.06.2008), nenit 73 të Statutit të Komunës, dhe kërkesës së Drejtorit të DSHPE-së, Kryetari i Komunës, më 19.03.2025 mori këtë:

V E N D I M

- I. Emërohet Komisioni për Vlerësimin dhe Inspektimin e objekteve që paraqesin rrezikshmëri për qytetarët e Komunës së Obiliqit, në këtë përbërje:
 1. Sami Haziri Kryetar i komisionit
 2. Ramadan Hashani anëtarë
 3. Ibrahim Krasniqi anëtarë
 4. Valon Berisha anëtarë
 5. Muhamet Pllana, anëtarë
- II. Për punën e vet Komisioni duhet të përpiloj raport me shkrim dhe ta njoftoj Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë e DSHPE-së.
- III. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

T'i dorëzohet:

- Kryetarit të Komunës
- anëtarëve të komisionit
- Drejtorit të DSHPE
- arkivit



Kryetari i Komunës

Xhafer Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No.

02-020-01-7643-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date

19. 03. 2025

OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Komuna Obiliq
Opština Obilič - Municipality Obiliq



ZYRA E KRYETARIT

Kabinet Presednika – Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 73 të Statutit të Komunës së Obiliqit nr.I-34 të dt.25.04.2016, dhe kërkesës së drejtores së Drejtorisë së Arsimit, Kryetari i Komunës, me 19.03.2025 nxjerrë:

V E N D I M

1. Caktohet Komisioni për Hartimin e para masës për kontratën "Furnizimi, mirëmbajtja dhe sanimi i nxemjeve qendrore, gjeneratorëve, radiatorëve në institucionet edukative arsimore dhe të institucioneve tjera në Komunën e Obiliqit ", e cila do të realizohet përmes kontratës " Kontrata në shtëpi" me NPL Kastrioti sh.p.k., në këtë përbërje:

1. Sadik Pllana – kryetar
2. Nexhmedin Durmishi – anëtar;
3. Izet Grajçevci – anëtar.

1. Obligohet komisioni të hartoj raportin e punës me cilën do të njoftoj drejtorin e DA dhe kryetarin e komunës.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarin e Komunës
- Drejtorit të DA
- anëtarëve të komisionit;
- Arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPSTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No.

02-020-01-8059-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date

24.03.2025

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Komuna Obiliq
Opstina Obilić - Municipality Obiliq



ZYRA E KRYETARIT

Kabinet Presednika – Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 te dt. 04.06.2008), nenit 73 të Statutit të Komunës (nr. I-34 të dt. 25.04.2016), Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare nr. 20 / 21.06.2016), kontratës AQP me nr. të protokollit 85/23 të datës 20.09.2023, dhe me nr të prokurimit UA/2016-23-6063-1-1-1, dhe me kërkesën e Drejtorisë së Administratës Përgjithshme , Kryetari i Komunës, më 24.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

PER PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT

nr.02-020-01-1363-25 të dt.14.01.2025

- I. Miratohet vendimi për plotësim-ndryshim të vendimit të Komisionit për pranim të mallit sipas projektit “Furnizim me material administrativ për Administratën komunale, si vijon :
 1. Amir Hashani- Kryetar i Komisionit
 2. Hamide Shabani, anëtare
 3. Valon Berisha, anëtar
- II. Komisioni ka për detyrë që në bashkëpunim me zyrtaren për pranimin e mallit të bëjë verifikimin e pranimit të mallit sipas specifikacionit të kërkuar në kontratë, dhe për punën e tyre duhet t’i raportojnë drejtorive përkatëse.
- III. Kontrata hyn në fuqi me 20.09.2023 dhe përfundon me datën 21.09.2025.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi ditë e nënshkrimit.

T’i dorëzohet:

- Kryetarit të Komunës
- anëtarëve të komisionit
- drejtorive
- prokurimit
- arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPSTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 02-020-01-3563-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date 06.02.2025

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova



Komuna Obiliq
Opština Obilić - Municipality Obiliq

ZYRA E KRYETARIT
Kabinet Predsednika – Office of the Mayor

Ne mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 81 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenit 72 dhe 73 të Statutit të Komunës nr. I-34 të dt. 25.04.2016 dhe kërkesës nr. 13-370-01-3356-25 të dt. 05.02.2025 nga Zyra e Prokurimit, kryetari i komunës me dt. 05.02.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Emërohet menaxher i kontratës **Urim Grajqevci** për projektin “Ritender – furnizimi dhe montimi i mbishkrimeve te Institucioneve komunale” me nr. të prokurimit OB614-24-13464-1-2-1.
- II. Punët kryhen nga Operatori Ekonomik: Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.
- III. Menaxheri i projektit ka për detyrë që të plotësojë planet për menaxhimin e kontratës ku specifikohen te gjitha përgjegjësit e tij.
- IV. Menaxheri i projektit për punën e tij duhet ti raportojë DA, DEFZH dhe Zyrën e prokurimit.
- V. Punimet duhet te kryhet brena 1095 ditëve nga dita e hyrjes ne fuqi te kontratës.

Te dorëzohet:

- Kryetarit,
- Drejt. DA
- Menaxh. Projekt.
- Prokurimit,
- arkivit

Kryetari i Komunës


Xhafer Gashi